



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 904/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e paraqitur nga Hidajete Krasniqi, kandidate për Kuvendin Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Pejë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** i bazuar Apeli Anr.904/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Hidajete Krasniqi, kandidate për Kuvendin Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Pejë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Pejë të subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Pejë, për Vendvotimet: 1723C/07R, BM 217/001, BM 217/002, BM 217/003.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në këto vendvotime, të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.904/2021 nga Hidajete Krasniqi, kandidate për Kuvendin Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Pejë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në të cilën thekson se nuk janë përfshirë në numërimin e votave nga diaspora respektivisht nga Zvicra 5 fletëvotime të dërguara me post me datën 08.10.2021 ku vërtetojnë se kanë votuar subjektin politik me nr. 121 - AAK dhe kandidatin për asamble komunale me nr. 9. Parashtruesja e apelit po ashtu thekson se votat e AAK-se nga vendvotimi 1723C/07R nuk janë paraqitur ku si parti ka fituar 63 vota e të dhënat janë vetëm për 4 kandidate e për të tjerët jo e sipas vëzhguesve të partisë

e njëjta thekson se i ka se paku 3 vota nga ky vendvotim. Si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidateve dhe emrat, dokumentet dhe fletëvotimet e disa personave për te cilët pretendon se kane votuar për të.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Paneli pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë nga ekipi i PZAP-it, më datë 04.11.2021, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hapja e kutisë se e votimit 1723C/07R, rezulton se janë 69 fletëvotime, ku për kandidaten me nr. 09 Hidajete Krasniqi nga subjekti politik AAK, rezulton se i ka 3 vota te vlefshme, ndërsa ne Formularin e Rezultateve te Kandidateve nuk e ka te shënuar asnjë votë. Ndërsa nga fletëvotimet e pavlefshme rezulton se 1 (një) fletëvotim është i pavlefshëm ne te cilin fletëvotim ka qene i shënuar numri 09 por se asnjë subjekt politik nuk ka qene i shënuar me tik, ndërsa për kandidaten me numër 09 Hidajete Krasniqi nga subjekti politik AAK ne komunën e Pejës përmes postes rezulton se i ka fituar 5 vota ne total, nga 3 kutit e votimit, ku në kutinë e votimit BM 217/001 kanë qene zero (0) vota, ne kutin BM 217/002 ka qene 1 vote dhe ne kutinë BM217/003 kane qene 4 vota

Vet fakti se me verifikim të pretendimeve të ankuesit, në provat e bashkangjitura në apel dhe nga hetimet e kryera në QNR, del se në vendvotimet e përmendura në pikën II të dispozitivit ka mungesë të votave të kandidates të subjektit politik AAK, ashtu siç pretendohet në apelin e lartpërmendur, gjë që tregon se rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ-ja, vërtetë del i pasaktë, dhe sipas vlerësimit të PZAP-së, është bazë e mjaftueshme për rinumërim ashtu siç është vendosur me këtë vendim. PZAP-i vlerëson se përveç tjerave, me rinumërim, askujt nuk i cenohet rezultati real dhe i vërtetë, përkundrazi për secilin kandidat për kuvend komunal del rezultat zgjedhor më i sigurt dhe i pranueshëm nga të gjithë.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve, të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi, andaj PZAP, nga këto arsye dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të kuvendit komunal në Pejë nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.904/21 më datë 06.11.2021

**Krvesues i Panelit**  
**Fejki Xhaferi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.